

Ambasador LULZIM PEÇI

Ambasador Lulzim Peçi është i lindur me 06 korrik 1966 në Prishtinë. Aktualisht ai shërben si Drejtor Ekzekutiv i Institutit Kosovar për Kërkim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED), Kryetar i Bordit të Drejtorëve të Fondacionit Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS) me seli në Prishtinë, si dhe anëtar i Komitetit Këshilldhënës për Ballkanin Perëndimor të Fondacionit për Shoqëri të Hapur.

Ambasadori Peçi ka shërbyer si Ambasador i Republikës së Kosovës rezident në Suedi dhe Ambasador jo-rezident në Islandë, Finlandë, Norvegji, Letoni dhe Lituani (2009-2013), si dhe shkurtimisht si Zyrtares i parë Ndërlidhës i Kosovës në Serbi (qershor 2013).

Ambasadori Peçi është inxhinier i diplomuar i elektronikës (1991) dhe ka qenë lauerat i çmimit “Student i Dalluar” i Universitetit të Prishtinës. Në vitin 1993 ai ka mbaruar specializim e post-diplomës në Qendrën e Gjenevës për Studime Aplikative të Negociatave Ndërkombëtare (CASIN), ndërsa studimet e masterit në marrëdhëniet ndërkombëtare i ka përfunduar me sukses të shkëlqyer në Institutin Universitar “Ortega y Gasset” në Madrid.

Para se t'i bashkangjitej shërbimit diplomatik, Ambasadori Peçi ka themeluar dhe ka qenë Drejtor Ekzekutiv i Institutit Kosovar për Kërkim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED) dhe Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Në periudhën 1995 – 1998 ka shërbyer si hulumtues në Qendrën e Kosovës për Studime Ndërkombëtare (KCIS) që ka qenë pjesë e ekipit të punëve të jashtme të Presidentit të ndjerë Dr. Ibrahim Rugova.

Në të kaluarën Ambasadori Peçi në mes tjerash ka qenë ligjërues vizitor në Qendrën e Gjenevës për Politika të Sigurisë (GCSP), anëtar i Bordit të Drejtorëve të Universitetit Amerikan në Prishtinë, si dhe ligjërues sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare në Univerzitetin e Prizrenit.

Ambasadori Peçi është autor dhe ko-autorë i më se 50 punimeve shkencore, kapitujve të librave dhe të politikave publike të cilat janë të botuara në Kosovë, Greqi, Britani të Madhe, Gjermani, Zvicër, Japoni dhe Tajlandë.